



Lajmet e Fundit: Përfundon misioni i Projektit PAMECA V në Policinë e Shtetit/Dekorohen drejtuesit



Lajmet

16/12/2021

Fier – Policia parandalon një ngjarje të mundshme kriminale, vihet në pranga 55-vjeçari

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Fier pas marrjes së informacionit se në Roskovec po ndodhte një konflikt mes dy shtetasve, menjëherë kanë organizuar punën dhe falë ndërhyrjes së shpejtë kanë parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të konfliktit.

Në qytetin e Roskovecit, për shkak të një konflikti për motive të dobëta, shtetasi B. H., ka goditur me mjet të fortë shtetasin V. H., i cili ka marë armën e gjahut dhe është nisur për në banesën e shtetasit B. H., por ndërhyrja e patrullës së Policisë ka bërë të mundur parandalimin e një ngjarje të mundshme kriminale duke e kapur në kohë shtetasin V. H bashkë me armën e gjahut (të cilën e kishte me leje).

Në vijim të veprimeve hetimore, specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Fier arrestuan për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” shtetasin B. H., 55 vjeç, banues në Roskovec dhe proceduan penalisht për veprat penale “Plagosje e lehtë me dashje” dhe “Kanosje” shtetasin V. H., 60 vjeç, banues në Roskovec (i cili ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve).

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprime të mëtejshme.

WhatsApp ShareFacebook ShareTwitter ShareLinkedIn ShareEmail

◀ Drejtori i Rendit Publik në Policinë e Shtetit, Ylli Vasili, deklaratë për mediat

Durrës – Vihen në pranga 3 shtetas, njëri prej tyre i shpallur në kërkim ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent